



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

## **PROCESI I VETËVLERËSIMIT TË OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

### **RAPORT KOMBËTAR PËR PROCESIN DHE REZULTATET**

**PERIUDHA E VETËVLERËSIMIT**

**2021-2022**

## SHKURTIMET

<b>AFP</b>	Arsim dhe Formim Profesional
<b>IoAFP</b>	Institucion ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional
<b>SD4E</b>	Programi i Zhvillimit të Aftësive për Punësim
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>AKAFP</b>	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
<b>AKPA</b>	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
<b>IoAFP</b>	Institucione ofruese të arsimit dhe formimit profesional
<b>QFP</b>	Qendër e Formimit Profesional
<b>Qa</b>	Sigurimi i Cilësisë
<b>SKPA</b>	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
<b>KSHK</b>	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
<b>NJZH</b>	Njësia e Zhvillimit
<b>OJF</b>	Organizata jofitimprurëse
<b>PEI</b>	Plane Edukative Individuale

## **PËRMBLEDHJE**

Mbështetur në Udhëzimin nr. 18, datë 6.7.2021, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 8.5.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”*”, të gjithë ofruesit publikë të AFP-së kanë zbatuar si çdo vit procesin e vetëvlerësimit sipas një kalendarit të hartuar dhe miratuar nga AKAFPK, kanë mbledhur të dhënat dhe kanë hartuar raportet individuale përfundimtare të vetëvlerësimit.

Në përfundim të procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2021-2022, u mbledhën të gjitha raportet individuale të vetëvlerësimit të dërguara nga ofruesit e AFP-së. Raportet janë analizuar nga sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së gjatë periudhës qershor-dhjetor 2023 për të përgatitur raportin përmbledhës për rezultatet e vetëvlerësimit në nivel kombëtar.

Në këtë raport është prezantuar kuadri historik dhe kuadri rregullator për sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri, në institucionet shtetërore të përfshira dhe përgjegjësitë e tyre.

Pasi është prezantuar instrumenti, metodologjia e vetëvlerësimit si dhe kalendarit i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit për vitin 2021-2022, janë prezantuar rezultatet e ofruesve të AFP-së për të pesë fushat e cilësisë. Në këtë raport është paraqitur analiza cilësore dhe analiza sasiore e të dhënave të mbledhura nga raportet e vetëvlerësimit si dhe nga platforma *scvet.al*. Pasi janë identifikuar çështjet që kanë nevojë për përmirësim, janë formuluar rekomandimet përkatëse sipas nënfushave, si dhe çështjet që do të merren në konsideratë nga AKAFPK për të përmirësuar më tej këtë proces.

## **KONTEKSTI HISTORIK**

Sistemi i AFP-së në Shqipëri është një sistem kryesisht me bazë shkollën dhe me pjesëmarrje shumë të ulët dhe të kufizuar të sektorit privat në hartimin dhe ofrimin e programeve të arsimit. Në sistemin e AFP-së, AKAFPK ka zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe ruajtjen e kualifikimeve profesionale i cili mbështet rëndësinë e kualifikimeve për tregun e punës. Në sfondin e politikave 10 vitet e fundit janë bërë përpjekje të shumta për ta zhvendosur fokusin drejt AFP-së dhe rezultatet kanë qenë të dukshme, ndër të cilat mund të përmendim aktivizimin për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kuadrit të kualifikimeve profesionale, përmirësimin e procesit të të nxënimit duke e vënë theksin te rëndësia e të nxënimit me bazë punën, rritjen e ndjekjes së shkollave profesionale, promovimin e AFP-së përmes aktiviteteve promociionale dhe konkurruese etj. Një përpjekje e mirë është gjithashtu pjesëmarrja e biznesit në bordet e shkollave, me synim rritjen e kontributit të sektorit privat dhe pjesëmarrjen më aktive dhe më efektive të tij në AFP, duke plotësuar hendekun që ekziston mes arsimit profesional dhe tregut të punës, si dhe duke rritur cilësinë.

Projekti SD4E, në bashkëpunim të ngushtë me AKAFPK dhe grupe të tjera interesi, punoi për të përcaktuar tiparet e dëshiruara dhe fizibilitetin e sistemit të sigurimit të cilësisë. Tashmë viti shkollor 2021-2022 ishte viti i pestë i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit, i cili dëshmon për një rritje të ndërgjegjësimit të ofruesve të AFP-së për rolin e vetëvlerësimit në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kriteret dhe standardet minimale të pranuar, pjesë e instrumentit të vetëvlerësimit, janë zbatuar edhe këtë vit nga të gjithë ofruesit publikë të AFP-së në Shqipëri. Këto standarde dhe kriteret përbëjnë bazën e modelit të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në AFP drejt modernizimit të kontekstit të arsimit profesional dhe garancisë që të diplomuarit e AFP-së të kenë njohuritë dhe kualifikimet për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit nga 44 ofrues publikë të AFP-së ka evidentuar aspektet pozitive, si dhe aspektet problematike, në të pesë fushat e cilësisë. Rezultatet e vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së janë konsideruar nga secili prej tyre për hartimin e raportit kombëtar të vetëvlerësimit.

## **KUADRI RREGULLATOR PËR VETËVLETËSIMIN (QA) NË SISTEMIN E AFP-SË NË SHQIPËRI**

### **Kuadri strategjik**

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, miratuar me Vendim nr. 176, datë 26.2.2020 ka si objektiv të përgjithshëm promovimin e punëve cilësore dhe të mundësive për aftësi për të gjitha gratë dhe burrat shqiptarë gjatë gjithë jetës; ky objektiv do të ndiqet me një sërë masash plotësuese dhe të ndërlidhura që njëkohësisht mbështesin ofertën e punës, nxisin kërkesën për punë dhe trajtojnë përjashtimin e thellë social. Strategjia është e përqendruar në katër shtylla ose linja masash që programi synon të arrijë. Një nga katër prioritetet strategjike (shtylla B) e SKPA 2019-2022 fokusohet në *“ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit”*, duke e vënë theksin te masat që synojnë përmirësimin e cilësisë së ofrimit në nivelin e ofruesve të AFP-së.

### **Kuadri ligjor**

Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”, kreu V “Sigurimi i Cilësisë” përcakton bazën për zhvillimin e një kuadri të sigurimit të cilësisë në sistemin shqiptar të AFP-së, duke përfshirë licencimin, vetëvlerësimin, inspektimin dhe akreditimin.

Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” (KSHK), i ndryshuar dhe i përmirësuar në vitin 2018 (Ligji nr. 23/2018, datë 10.5.2018), përshkruan veçoritë kryesore të KSHK-së, si strukturën, fushën e veprimit, objektivat dhe funksionet, si dhe masat për qeverisjen, menaxhimin institucional, sigurimin e cilësisë dhe financimin. Fokusi kryesor i parashikuar nga ligji, ndër shumë të tjera, thekson çështjen e sigurimit të cilësisë në AFP. Kjo do të thotë që të gjitha institucionet e arsimit dhe formimit profesional duhet të plotësojnë standarde

të caktuara të cilësisë përsa i përket burimeve njerëzore dhe fizike, sistemeve dhe procedurave, menaxhimit, procesit të të nxënimit etj. Sigurimi i cilësisë duhet të jetë guri i themelit i çdo institucioni që ofron arsim dhe formim profesional dhe një aspekt shumë i rëndësishëm për përmirësimin e imazhit të AFP-së dhe prodhimin e një force punëtore të kualifikuar për tregun e punës.

Për më tepër, kuadri ligjor për arsimin parauniversitar (Ligji nr. 69/2012 dhe legjislacioni dytësor përkatës) parashikon rregullat dhe kriteret për kuadrin e zhvillimit institucional dhe të cilësisë, veçanërisht për ofruesit e AFP-së që ofrojnë programe të arsimit të mesëm të lartë. Janë përcaktuar procedura dhe kriteret të qarta lidhur me : 1) planin strategjik afatmesëm (4 vjeçar); 2) planin vjetor të punës dhe 3) fushën e veprimit, zbatimin dhe përdorimin e vetëvlerësimit të institucioneve parauniversitare, duke përfshirë shkollat e AFP-së.

Së fundi, *Udhëzimi i Ministrisë nr.16, datë 8 maj 2018*, i cili miraton Udhëzuesin Zyrtar për vetëvlerësimin dhe përcakton përgjegjësitë e ofruesve dhe institucioneve në nivelin qendror, si dhe Udhëzimi i Ministrisë nr. 16/1, datë 16 tetor 2018, i ndryshuar, përcaktojnë arritjen e parë kyçe për një zbatim gjithëpërfshirës të kuadrit të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë shkollat e AFP-së, dhe Qendrat e Formimit Profesional.

## **Kuadri institucional për sigurimin e cilësisë në AFP**

### **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**

Në cilësinë e institucionit më të lartë përgjegjës për politikën e AFP-së, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është besuar me ligj detyra e krijimit të kuadrit të sigurimit të cilësisë në sistemin e AFP-së, duke përfshirë të gjithë komponentët e këtij sistemi, siç janë licencimi, hapja dhe mbyllja e ofruesve publikë të AFP-së, si dhe miratimi i legjislacionit dytësor për akreditimin, vetëvlerësimin, monitorimin dhe inspektimin. Më konkretisht, Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e bazës ligjore, garantimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare dhe sigurimin e infrastrukturës. Në sektorin publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për miratimin e hapjes, organizimit dhe mbylljes së ofruesve publikë të AFP-së mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Ajo miraton ofrimin e programeve të AFP-së në bazë të kualifikimeve kombëtare të ofruara nga ofruesit publikë të AFP-së dhe miraton modelin, standardet dhe kriteret e akreditimit të propozuara nga AKAFPK. Ministria bashkëpunon ngushtë me Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe jep miratimin fillestar përsa i përket licencimit të ofruesve privatë të AFP-së. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i takon gjithashtu një nga funksionet kyçe të sigurimit të cilësisë, i cili është inspektimi.

## **Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)**

AKAFPK është institucioni përgjegjës për krijimin e një sistemi të unifikuar të kualifikimeve profesionale të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, një sistem që u mundëson nxënësve/kursantëve/individëve të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca për të përballuar sfidat e zhvillimit social-ekonomik të vendit. AKAFPK mbështet ministrinë përgjegjëse për të forcuar dimensionin evropian të sistemit shqiptar të kualifikimeve. Në sektorin e AFP-së, AKAFPK ka përgjegjësi dhe kompetencë të plotë për të ushtruar funksionet kryesore të KSHK-së. Ndër detyrat e tjera dhe në lidhje me zbatimin e ligjit për KSHK-në, AKAFPK kryen vlerësimet e kualifikimeve profesionale dhe i krahason ato me kualifikimet ndërkombëtare, si dhe propozon ndryshime në kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të përfshira në KSHK.

## **Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)**

Bazuar në nenin 9 të ligjit për AFP-në, AKPA është përgjegjëse për menaxhimin e rrjetit të ofruesve publikë të AFP-së. Me këtë detyrë, AKPA është përgjegjëse për monitorimin e veprimtarisë së përditshme të ofruesve të AFP-së. Krahas kësaj, AKPA-së i është besuar detyra e mirëmbajtjes dhe përditësimit të regjistrit kombëtar të certifikatave, si dhe detyra e gjurmimit të nxënësve të AFP-së pas diplomimit/certifikimit.

## **INSTRUMENTI DHE METODOLOGJIA E VETËVLERËSIMIT**

Elementët e metodologjisë së vetëvlerësimit në AFP përfshijnë 5 dimensionet e cilësisë së veprimtarisë së ofruesve të AFP-së. Instrumenti i vetëvlerësimit i hartuar me mbështetjen e programit SD4E ka shërbyer për të udhëhequr zbatimin e procesit të vetëvlerësimit dhe shpjegon në mënyrë të hollësishme të gjitha fushat, duke përfshirë nënfushat e secilës fushë. Ai përfshin përshkrimet e fushave, nënfushave, treguesve, kriterëve, niveleve të vlerësimit dhe standardeve.

**Fusha** nënkupton një dimension themelor të veprimtarisë së ofruesit të AFP-së dhe lidhet drejtpërdrejt me të gjithë veprimtarinë e tij. Përcaktimi i fushave të veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin profesional dhe arsimin e përgjithshëm. Janë përcaktuar këto fusha kryesore të vetëvlerësimit:

- I. Menaxhimi dhe drejtimi
- II. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi
- III. Kurrikula e zbatuar
- IV. Mësimdhënia dhe të nxënësve
- V. Vlerësimi

**Nënfusha** është një nën-ndarje me detaje dhe elemente që tregon dhe plotëson më së miri përmbajtjen e një fushe të caktuar në të cilën punon ofruesi i AFP-së. Për shembull, nëse njëra nga fushat është *“Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi”*, nënfushat janë *“Marrëdhëniet me komunitetin dhe shoqërinë civile”*, *“Marrëdhëniet me biznesin”* etj.

Këto nënfusha synojnë të identifikojnë se çfarë marrëdhëniesh dhe çfarë forma bashkëpunimi ka institucioni i AFP-së me partnerët e tij. Ato konsiderohen si një mundësi për të identifikuar, për të vëzhguar dhe për të vlerësuar në imtësi atë që ndodh brenda ofruesit të AFP-së. Pra nënfushat kryejnë dy funksione:

- zbërthejnë fushën në elementë organike të domosdoshme për të;
- mundësojnë njohjen dhe vlerësimin real të situatës brenda ofruesit të AFP-së.

**Treguesi** është një fjali e matshme pohuese që tregon se si është dhe si duhet të jetë fusha. Përmes treguesve, ne vlerësojmë se si është vetëvlerësuar ofruesi i AFP-së.

Karakteristikat e treguesve:

- hartohen për secilën nënfushë dhe mund të jenë një ose disa të tillë;
- janë gjithnjë të matshëm, gjë që do të thotë se ata lehtësojnë procesin e vetëvlerësimit;
- paraqesin pohime që specifikojnë fushën që do të vlerësohet.

**Kriteri** është një nën-ndarje e treguesve i shprehur në formën e një fjalie që përcakton si është zbatuar, si është organizuar apo në ç’gjëndje paraqitet treguesi. Ai sugjeron mbledhjen e informacioneve dhe mundëson arritjen e treguesve nga institucioni i AFP-së.

**Nivelet e vlerësimit** janë nivelet e përdorura për vlerësimin e institucionit të AFP-së nëpërmjet fushave të tij. Vlerësimi kryhet për çdo kriter të secilit tregues të një fushe. Nivelet e vlerësimit janë katër: shumë mirë, që përkon me numrin 1; mirë, që përkon me numrin 2; mjaftueshëm, që përkon me numrin 3; dhe dobët, që përkon me numrin 4. Skema me katër nivele vlerësimi është mjaft e përdorur në vlerësimet e ofruesve të AFP-së në vendet e Evropës. Po ashtu, ky sistem me katër nivele mundëson një vlerësim real dhe përfshin të gjitha nivelet që mund të arrijnë institucionet e AFP-së sipas treguesve.

**Standardi** është përshkrimi i situatës së ofruesit të AFP-së për secilën fushë, i cili mundëson një vlerësim sipas niveleve të mësipërme të vlerësimit. Ky vlerësim është rezultat i përpunimit të të dhënave të instrumenteve të monitorimit dhe vlerësimit të siguruara për secilin tregues dhe kriter, por edhe i të dhënave të siguruara nga metodologjia e zbatuar gjatë vlerësimit të brendshëm. Vlerësimi përfundimtar për një fushë specifike bazohet gjithmonë në peshën dhe rëndësinë e zbatimit të secilit tregues dhe kriter në situatën e ofruesit të AFP-së.

**KALENDARI I ZBATIMIT TË PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT 2021-2022 NË  
OFRUESIT E AFP-SË**

<b>Nr.</b>	<b>Hapat që duhen ndërmarrë</b>	<b>Afati</b>	<b>Personat përgjegjës</b>
1	Krijimi i ekipit përgjegjës të vetëvlerësimit	3 tetor 2022	Drejtuesi i IoAFP-së
2	Miratimi i ekipit përgjegjës të vetëvlerësimit nga këshilli i mësimdhënësve	5 tetor 2022	Këshilli i mësimdhënësve
3	Hartimi i planit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë	7 tetor 2022	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
4	Miratimi i planit të vetëvlerësimit nga drejtuesi i IoAFP-së	12 tetor 2022	Drejtuesi i IoAFP-së
5	Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë duke përdorur edhe platformën digjitale <a href="http://www.scvet.al">www.scvet.al</a> (plotësimi i pyetësorëve, vëzhgime, mbledhje informacioni, etj.)	30 dhjetor 2022	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit/ Drejtuesi i IoAFP-së/Bordi i IoAFP-së/ mësimdhënësit/Stafi mbështetës/ nxënësit/kursantët/ bizneset
6	Përpunimi i të dhënave dhe hartimi i raportit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë, duke përfshirë në raport “Instrumentin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë”	16 janar 2023	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
7	Përgatitja e raportit final të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë	25 janar 2023	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
8	Monitorimi dhe mbështetja e procesit të vetëvlerësimit nga specialistët të AKAFPK	Tetor 22- Janar 23	Specialistët të AKAFPK
9	Prezantimi i raportit final të vetëvlerësimit në këshillin e mësimdhënësve dhe miratimi i tij nga bordi i IoAFP-së	27 janar 2023	Drejtuesi i IoAFP-së/ këshilli i mësimdhënësve /Bordi i IoAFP-së
10	Hedhja e raportit final të vetëvlerësimit në platformën digjitale <a href="http://www.scvet.al">www.scvet.al</a>	31 janar 2023	Drejtuesi i IoAFP-së

**REZULTATET E PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT 2021-2022**

Procesi i vetëvlerësimit u finalizua nga 44 ofrues të AFP-së të cilët i dorëzuan raportet individuale të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2021-2022. Rezultatet e raporteve u përpunuan dhe u përmbledhën nga specialistët e AKAFPK-së në sektorin e akreditimit të ofruesve të AFP-së, të cilët analizuan të dhënat sasiore dhe cilësore. AKAFPK-ja ka mbajtur një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me secilin nga 44 ofruesit e AFP-ve, ku secilit prej ofruesve i është komunikuar progresi i arritur si dhe është diskutuar për të metat apo mangësitë që kanë pasur.



Raporti ka marrë në konsideratë në mënyrë të përmbledhur të gjitha nënfushat e të *pesë* fushave të cilësisë që përdor instrumenti i *vetëvlerësimit* për të matur ecurinë e cilësisë të ofruesit të AFP-së. Çdo nënfushë do të ndahet në dy pjesë ku në pjesën e parë do të renditet rezultati që është arritur kurse në pjesën e dytë do të vihen në dukje dobësitë që janë evidentuar. Në vijim janë paraqitur rezultatet sasiorë dhe rezultatet cilësore për secilin prej ofruesve të AFP-së nëpërmjet paraqitjes në formë grafike.

Në përfundim të raportit, janë formuluar rekomandimet përkatëse për çështjet që duhen përmirësuar në të ardhmen.

## **FUSHA 1: MENAXHIMI DHE DREJTIMI**

IoAFP-të kanë zbatuar procesin e vetëvlerësimit për vitin shkollor 2021-2022 dhe e kanë dorëzuar pranë AKAFPK-së brenda afateve të paracaktuara në “Kalendarin e zbatimit të procesit të vetëvlerësimit 2021-2022 në ofruesit e afp-së”.

Përgjatë verifikimit të fushës së parë “*menaxhim dhe drejtimi*” IoAFP-të kanë zhvilluar aftësi organizative duke ngritur grupe pune, duke ndarë role dhe procese për çdo grup pune.

Ka një përfshirje të stafit mësimor, të cilët janë kontribues në hartimin e raportit të vetëvlerësimit, duke zhvilluar një proces transparent, bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës.

Në lidhje me fushën e parë “*menaxhim dhe drejtimi*” çka përbën edhe fushën kryesore të zhvillimit të vetëvlerësimit, sepse përmban në vetvete menaxhimin, organizimin dhe drejtimin e burimeve që vetë IoAFP-ja ka, shikohet një përkushtim më i madh dhe një interes i lartë nga vetë drejtuesit e IoAFP-ve.

Duke mbajtur të njëjtë linjën e paraqitjes së formatit të raportit kombëtar me raportin e viti 2020-2021 më poshtë listohen nënfushat me zhvillimet që ato paraqesin në rang kombëtar për të gjithë IoAFP-të.

1. Gjithëpërfshirja
2. Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së
3. Plani vjetor i ofruesve të AFP-së
4. Plani i vëzhgimit të orëve mësimore
5. Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional
6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve
7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së
8. Zhvillimi profesional i stafit

## 9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare

### 1. Gjithëpërfshirja

#### a. Rezultati

Nënfusha “gjithëpërfshirja” plotësohet nga IoAFP-të. Vetë IoAFP-të kanë fituar aftësi organizative për të krijuar strukturat bazë që do të shërbejnë për planifikimin, zhvillimin, organizimin, monitorimin dhe raportimin e të gjithë aktivitetit të IoAFP-së. Të gjithë strukturat janë ngritur si: Bordi i IoAFP-së, Këshilli i mësuesve, Qeveria e nxënësve, Këshilli i prindërve të IoAFP-së, Këshilli i Prindërve të Klasës, Komisioni i Disiplinës, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes.

#### b. Dobësitë

Mbetet ende një dobësi përfshirja e prindërve kjo për arsye nga më të ndryshmet, e cila ndryshon nga qyteti në qytet, kryesisht arsyet që renditen janë angazhimet në punë, arsyet e emigrimit, shpesh edhe distanca fizike, ka edhe prindër që nuk shfaqin interes apo dhe pamundësi reale për t’u përfshirë.

### 2. Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së

#### a. Rezultati

Planet afatmesëm sa vijnë dhe detajohen si dhe qartësohen më mirë, kjo falë edhe punës së AKAFP-së e cila kërkon plane afatmesme të mirë planifikuara dhe të qarta, në përputhje me strategjinë kombëtare të punësimit me qëllim që në vetvete planet afatmesme ti përgjigjen kërkesave që janë parashtruar në strategjinë kombëtare të punësimit.

#### b. Dobësitë

Nuk shikohet ndonjë dobësi e theksuar në planifikim. Inkurajohet që plani afatmesëm t’i përgjigjet zonës ku IoAFP-ja është fizikisht dhe të marrë në konsideratë të gjithë aktorët lokalë.

### 3. Plani vjetor i ofruesve të AFP-së

#### a. Rezultati

Planet vjetore hartohen nga ofruesit e AFP-së dhe reflektojnë zbërthimin më me detaje të planit afatmesëm, aktorët e brendshëm të ofruesit bashkëpunojnë në hartimin e planit vjetor si dhe merren në konsideratë edhe sugjerime që këta aktorë të brendshëm japin, gjithashtu plani vjetor verifikohet dhe miratohet nga Bordi i ofruesit.

#### b. Dobësitë

Sërish mbeten sfidë aktorët e jashtëm në hartimin e planit vjetor, kërkohet një përfshirje më e madhe dhe një bashkëpunim më i ngushtë i tyre. Aktivitetet duhet të qartësohen edhe më mirë.

### 4. Plani i vëzhgimit të orëve mësimore

#### a. Rezultati

IoAFP-të e zbatojnë planin e vëzhgimit të orëve mësimore dhe e kryejnë me cilësi këtë veprimtari, mbahen shënime dhe rekorde përgjatë vlerësimit të tyre, gjetjet e ndryshme

reflektohen dhe merren masat e duhura për përmirësimin apo zgjidhen e çështjeve të ndryshme që mund të dalin.

*b. Dobësitë*

Cilësia e dokumentimit të punës dhe matja e saj duhet të përmirësohet.

## **5. Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional**

*a. Rezultati*

IoAFP-të e kryejnë planin e monitorimit dhe e kanë të përvetësuar më së miri.

*b. Dobësitë*

Në përgjithësi ofruesit e AFP-ve nuk shfaqin dobësi në këtë dimension.

## **6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve/kursantëve**

*a. Rezultati*

IoAFP-të e kryejnë zbatimin e procedurave për transferimin, ruajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit sipas kërkesave të legjislacionit. Përgjithësisht kërkesat për këtë nënfushë janë të qarta dhe zbatohen rregullisht prej ofruesve të AFP-së.

*b. Dobësitë*

Nuk janë vërejtur dobësi në këtë nënfushë.

## **7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së**

*a. Rezultati*

Vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së kryhet çdo vit. Drejtoritë marrin masat e nevojshme dhe ngrenë grupet përkatëse të punës. Megjithëse është viti i pestë sërish shikohet pak progres në këtë drejtim.

*b. Dobësitë*

Raportet e vetëvlerësimit nuk kanë një cilësi në shkrim. Në disa IoAFP raportet e vetëvlerësimit janë të paqarta. Shpesh vetëvlerësimi shikohet si një punë e tepërt, ose shumë e ngarkuar. Nga verifikimet është konstatuar se ka edhe copy-paste nga raportet e viteve të kaluara. Stafet dhe grupet e punës që janë të angazhuar më këtë detyrë e kanë të nevojshme që të trajnohen dhe të zhvillojnë kapacitetet e tyre.

## **8. Zhvillimi profesional i stafit**

*a. Rezultati*

IoAFP-të e marrin në konsideratë zhvillimin e stafit dhe kryejnë planifikime të përhershme për trajnimin e tyre.

*b. Dobësitë*

Do të duhet që në trajnimet e stafeve të zhvillohen edhe trajnime në lidhje me shkrimin e raporteve, kryerjen e analizave etj.

## 9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare

### a. Rezultati


Ofruesit e AFP-së realizojnë me efikasitet menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare. Ofruesit identifikojnë nevojat e tyre për personel mësimor, përcaktojnë dhe ndajnë qartë detyrat për personelin, mundësojnë bashkëpunimin midis stafit mësimor me stafin mbështetës, menaxhojnë buxhetin e miratuar sipas programit dhe në mbështetje të ligjeve.

### b. Dobësitë


Kapacitetet e stafeve kanë nevojë të zhvillohen më shumë edhe në drejtimin e menaxhimit të shkollës dhe jo vetëm në mësimdhënie.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet vlerësimi për secilin prej 44 ofruesve të AFP-së , për fushën 1 “Menaxhimi dhe drejtimi”.


Rezultati fushës “Menaxhimi dhe drejtimi” sipas institucioneve



Nga analiza e rezultateve të vetëvlerësimit u arrit në përfundimin se 32 prej ofruesve publikë të AFP-së e kanë vlerësuar veten “Shumë mirë” për fushën 1, 12 prej tyre e kanë vlerësuar veten “Mirë”. Asnjë prej ofruesve nuk e ka vlerësuar veten “Mjaftueshëm” ose “Dobët”.



Në grafikun e mëposhtëm tregohet vlerësimi për secilën nënfushë të Fushës 1.



## FUSHA 2 - MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI

Fusha e dytë e vetëvlerësimit përfshin "Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi," thelbësore për të vlerësuar nivelin e bashkëpunimit që ofruesi i AFP-së zhvillon, pasi është pikë referimi për suksesin dhe arritjen e qëllimeve të veta. Ofruesi i AFP-së ka një liri të gjerë për të përdorur çdo formë të bashkëpunimit me qëllim të përmirësimit dhe profesionalizimit të shërbimit të AFP-së. Realizimi i këtyre veprimtarive ndihmon në rritjen e besueshmërisë dhe konkurrueshmërisë në treg.

Fusha 2 përbëhet nga katër nënfushat në vijim:

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore.
2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin.
3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin
4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve.

### **1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore**

#### *a. Rezultati*

Reflektohet një rritje në nivelin e bashkëpunimit mes ofruesve të AFP-së, institucioneve qendrore dhe institucioneve lokale që mbulojnë arsimin dhe formimin profesional. Tashmë është stabilizuar dhe është kthyer në kulturë pune bashkëveprimi midis ofruesve të AFP-së dhe institucioneve qeveritare nëpërmjet komunikimit zyrtar, implementimit të udhëzimeve,

raportimit të informacionit zyrtar, organizimit të aktiviteteve dhe takimeve të përbashkëta, si dhe dokumentimit të rregullt të këtyre marrëdhënieve.

*b. Dobësitë*

Vijojnë të mbeten të pa konsoliduara dhe pa përmirësim marrëdhëniet me qeverisjen vendore. Disa ofrues vazhdojnë të paraqesin problemin e përfshirjes së përfaqësuesve të qeverisjes lokale në menaxhimin institucional si dhe nuk kanë hapësirë komunikimi për t'i njoftuar zyrtarisht lidhur me projektet e bashkëpunimit, risitë, arritjet, aktivitetet dhe çështje që lidhen me promovimin. Këto dobësi nuk janë sfumuar edhe pse ofruesit kanë ndërmarrë një seri veprimesh për përmirësimin e tyre, por mesa duket nuk kanë qenë të mjaftueshme për të sfiduar indiferentizmin e qeverisjes vendore. Qeverisja lokale në shumë raste nuk fton ofruesit në takime zyrtare, gjithashtu nuk zhvillohen mjaftueshëm praktika profesionale në këto institucione. Dobësi nga ana e ofruesve vazhdon të mbetet planifikimi dhe zbatimi i veprimtarive me aspekte gjinore në bashkëpunim me institucionet vendore.

## **2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin**

*a. Rezulati*

Krahasuar me rezultatet e viteve të shkuara, bashkëpunimi i IoAFP-ve me komunitetin e biznesit është konsoliduar dhe ka përmirësime të dukshme. Ofruesit disponojnë të dhëna për shtrirjen e bizneseve në komunitetin e tyre, shkëmbejnë informacione si dhe nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi. Njësia e zhvillimit me koordinatorin e marrëdhënieve me biznesin, ka krijuar kompetencën për të ndjekur, përmirësuar dhe intensifikuar këto veprimtari.

*b. Dobësitë*

Nga raportet e ofruesve të AFP-së konstatohet se disa ofrues vazhdojnë të mos realizojnë në mënyrë periodike analizën e tregut për zonën ku zhvillojnë veprimtarinë e vetë. Edhe tek kjo nënfushë vërehet dobësi nga ana e ofruesve planifikimi dhe zbatimi i veprimtarive me aspekte gjinore në bashkëpunim me biznesin.

## **3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin**

*a. Rezulati*

Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqërinë civile përsëri nuk kanë shënuar zhvillime të dukshme. Ofruesit kanë plane të qarta dhe përfshijnë prindërit në jetën institucionale, janë pjesëmarrës në organizmat vendimmarrëse dhe ekziston një komunikim i vazhdueshëm për çështjen e funksionimit të shkollës dhe për zhvillimin e nxënësve. Krahasuar me rezultatet e një viti të mëhershëm ofruesit që disponojnë të dhëna për OJF-të në rajon janë shtuar por jo të gjithë kanë pasur përmirësime.

## b. Dobësitë

Siç bëhet e dukshme nga vlerësimet e ofruesve të AFP-së, janë ndërmarrë hapa pozitivë për të përfshirë komunitetin në proceset institucionale. Megjithatë, ofruesit nuk kanë mundur të realizojnë bashkëpunimin me komunitetin për çështje si: studime dhe analiza të nevojave të tregut të punës apo dhe për projekte të ndryshme që lidhen me edukimin dhe barazinë gjinore. Një pjesë e ofruesve ende nuk kanë përmbushur objektivin për identifikimin, studimin dhe menaxhimin e të dhënave të OJF-ve. Hartimi i projekteve zhvillimore për të siguruar mbështetje nga OJF-të për: veprimtari ekstrakurrikulare, trajnime për stafin, përmirësimin e menaxhimit institucional mbeten ende sfidë për shumicën e ofruesve. Po ashtu, ofruesit edhe këtë vit nuk kanë marrë masa për planifikimin e veprimtarive në bashkëpunim me komunitetin dhe shoqërinë civile me aspekte gjinore.

## 4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve

### a. Rezultati


Ofruesit e AFP-së kanë identifikuar institucionet homologe dhe tashmë kanë ndërtuar një nivel të bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave profesionale. Për të arritur një nga qëllimet kryesore të tyre, që është rritja e numrit të nxënësve/kursantëve në AFP, ata monitorojnë dhe implementojnë në mënyrë të rregullt planin e tyre të promovimit duke organizuar veprimtari dhe aktivitete të ndryshme, përfshirë këshillimin e karrierës, organizimin e ditëve të hapura për të ofruar informacion, përfshirjen në panairë dhe promovimin në rrjetet sociale.

### b. Dobësitë


Ofruesit nuk kanë mundur të jenë më efektiv në krijimin e binjakëzimeve me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu, marrëdhëniet me institucionet e arsimit të lartë dhe ato të arsimit post sekondar për zhvillimin profesional, kanë vend për përmirësime dhe nuk janë konsoliduar mjaftueshëm.

Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitet si më poshtë.


Rezultati fushës "Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi" sipas institucioneve



Në formë grafike rezultati i nënfushave të Fushës 2 "Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi" do të paraqitet si më poshtë:



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën “Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi” ka rezultuar se 22 prej tyre e shohin vetën “Shumë mirë” në këtë fushë, 21 prej tyre e shohin vetën “Mirë”, 0 prej tyre e shohin vetën “Mjaftueshëm”, asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar veten “Dobët, ndërkohë një ofrues ka rezultuar “Pa vlerësim”. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:





## **FUSHA 3-KURRIKULA E ZBATUAR**

Kjo fushë lidhet me zhvillimin e kurrikulës së ofruesit të AFP-së në përputhje me standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve profesionale brenda autonomisë së ofruesit të AFP-së, për hartimin dhe zbatimin e saj në nivel ofruesi, si dhe mundëson formimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave profesionale. Fusha 3 përbëhet nga 5 nënfushat si më poshtë:

1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së
2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së
3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm
4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës
5. Ekipi kurrikular

### **1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së**

#### *a. Rezultati*

Kjo nënfushë nuk ka pasur problematika të theksuara për shkollat e arsimit profesional. Në planifikimin dhe në zbatimin e kurrikulës, mësime të mbështetura në dokumente zyrtare, si skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale si dhe udhëzimet përkatëse për lëndët e kulturës së përgjithshme. Ekipet përgjegjëse përgatisin planet mësimore, programet mësimdhënëse, orët për zhvillimin e teorisë dhe praktikës profesionale etj.

#### *b. Dobësitë*

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimeve të ofruesve të AFP-së si dhe nga të dhënat e plotësuar në platformën *scvet.al*, u konstatuan disa dobësi të cilat lidhen me mosparashikimin e disa orëve mësimore mbështetëse për nxënësit e prapambetur të cilët nuk kanë arritur rezultate mësimore të caktuara. Kjo problematikë është vërejtur në katër ofrues AFP-je. Gjithashtu janë shumë pak raste për t'i përgjithësuar në nivel kombëtar të ofruesve në të cilët plani mësimor duhet të përshtatet me mjediset e shkollës dhe mjediset e praktikës profesionale, dhe me planifikimin e nxënësve që do të vlerësohen gjatë orëve mësimore.

### **2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së**

#### *a. Rezultati*

Ky kriter plotësohet nga Qendrat e Formimit Profesional dhe nga shkollat që ofrojnë kurse të unifikuar. Në nivel kombëtar nuk janë evidentuar problematika të theksuara. Programet e kurseve zhvillohen në përputhje me dokumentet zyrtare, si dhe me nevojat e tregun të punës.

#### *b. Dobësitë*

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit u konstatua se vetëm në dy QFP kanë raportuar se analiza e nevojave të tregut zhvillohet çdo vit, por nuk dokumentohet, në njërin dhe tjetra raportin se analiza e nevojave të tregut nuk është e plotë.

### **3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm**

#### *a. Rezultati*

Kjo nënfushë plotësohet vetëm nga shkollat. Planet tremujore ose vjetore lëndore hartohen në përputhje me dokumentet kurrikulare, duke përcaktuar shpërndarjen e kohës për të gjitha lëndët, si dhe zbatohen në praktikë pas miratimit nga drejtori i shkollës. Projektet kurrikulare prezantohen përpara klasës. Ato vlerësohen me notë duke u mbështetur në kriteret përkatëse.

#### *b. Dobësitë*

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit dhe të dhënave në platformën elektronike të vetëvlerësimit, është konstatuar se jo të gjithë mësimmshënësit hartojnë veprimtari të diferencuara për nxënësit me nevoja të veçanta. Ka raste kur mësimmshënësit përpiqen brenda mundësive të tyre për t'i ndihmuar këta nxënës duke planifikuar veprimtari, por është e vështirë të arrihen rezultatet e pritura pasi kërkohet një mbështetje më e specializuar për këtë kategori nxënësish. Në disa raste veprimtaritë mbështetëse, realizohen por nuk dokumentohen. Në projektet e nxënësve nuk përfshihen të gjitha elementet e përcaktuara në kriterin e vetëvlerësimit. Përgjithësisht, në planet lëndore shkruhen vetëm teknikat e vlerësimit. Në detyrat dhe punët e pavarura mungojnë trajtimi i çështjeve të barazisë gjinore. Ofruesit e AFP-së nuk bashkëpunojnë me prindërit për tematikat dhe realizimin e projekteve kurrikulare, dhe kjo ndodh për shkak të mungesës së interesimit të prindërve ose për arsye të distancës nga shkolla dhe statusit socio-ekonomik. Projektet kurrikulare nuk prezantohen përpara një publiku më të gjerë se klasa. Jo të gjithë mësimmshënësit përcaktojnë detyra individuale dhe në grup sipas stileve të të nxënësit si dhe kohën për refleksion (feedback).

### **4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës**

#### *a. Rezultati*

Nxënësit kanë tekste mësimore për lëndët e kulturës së përgjithshme, të cilat ndjekin procedurat zyrtare të përzgjedhjes. Për lëndët e kulturës profesionale ofruesit mbështeten në materialet mësimore mbështetëse të hartuara nga AKAFPK. Nxënësit janë të pajisur me materiale mbështetëse mësimore. Mësuesi bashkëpunon në mënyrë efektive me nxënësit për të krijuar mjetet mësimore për zhvillimin e lëndëve.

#### *b. Dobësitë*

Pjesa më e madhe e ofruesve të AFP-së kanë raportuar për disa pika të dobëta për këtë nënfushë. Ofruesit nuk bashkëpunojnë me prindërit në krijimin e mjeteve mësimore. Edhe në rastet kur ka pasur bashkëpunim, kjo nuk është e dokumentuar. Një problematikë tjetër e theksuar është

mungesa e teksteve profesionale. Në këto kushte, nxënësit përdorin materialet mësimore të përgatitura nga mësimdhënësit të cilat shpërndahen me fotokopje ose elektronikisht. Ka ofrues në të cilët mungojnë laboratorët virtuale ose janë në sasi të pakët për të mbuluar nevojat e të gjithë nxënësve. Përsa i përket lëndës së edukimit fizik ka shkolla të cilat nuk kanë palestër, por kanë vetëm ambiente të jashtme, ose kanë mjetet për zhvillimin e lëndës por nuk kanë hapësira të dedikuara. Në disa ofrues nuk ka pajisje të praktikës profesionale për të gjitha kualifikimet profesionale që shkolla ofron, ose nuk janë të teknologjive bashkëkohore. Në lidhje me ambientet e shkollës, pak ofrues kanë raportuar se ndërtesa ka dëmtime si p.sh dëmtime gjatë tërmetit, probleme me soletën ose kushtet e përgjithshme të ndërtesës janë në gjendje minimale. Pavarësisht se këto problematika nuk janë evidentuar në një numër të madh ofruesish, është e rëndësishme që të merren masat përkatëse.

## 5. Ekipi kurrikular

### a. Rezultati


Përgjithësisht në nivel kombëtar, ofruesit e kanë ngritur ekipin kurrikular në përputhje me kërkesat zyrtare të cilët hartojnë programet e mësimdhënies të lëndëve teorike profesionale si dhe të moduleve praktike.

### b. Dobësitë


Nga analiza e nënfushës ka rezultuar se ekipi kurrikular nuk fton në mbledhjet e tij përfaqësues të Bordit, të Qeverisë së nxënësve dhe Këshillit të Prindërve të shkollës. Gjithashtu edhe në disa ofrues që kanë treguar se takimet midis tyre janë realizuar, mungon prezenca e prindërve ose koordinatori përgjegjës ka njoftuar Bordin por ai nuk ka qenë aktiv. Ekipi kurrikular nuk përzgjedh projektet që do t'u ofrohen nxënësve, pas propozimeve të ekipit lëndor të kurrikulës së formimit të përgjithshëm. Janë vetëm dy ofrues AFP-je të cilët nuk e kanë ngritur ekipin kurrikular për shkak se numri i mësimdhënësve është i vogël.

Rezultati i fushës 3 për 44 ofruesit publikë të AFP-së paraqitet në këtë mënyrë.


Rezultati fushës "Kurrikula e zbatuar" sipas institucioneve



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën 3: “Kurrikula e zbatuar” , është arritur në përfundimin se 24 ofrues publikë të AFP-së, e kanë vlerësuar veten “Shumë mirë”, 20 prej tyre e kanë vlerësuar vetën “Mirë”. Nuk ka asnjë ofrues AFP-je që e ka vlerësuar veten “Mjafatueshëm” ose “Dobët”.



Në grafikun e mëposhtëm tregohet vlerësimi i nënfushave për ofruesit e AFP-së për fushën 3: Kurrikula e zbatuar.



## FUSHA 4 –MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Kjo fushë lidhet me dy procese thelbësore të cilat synojnë përvetësimin e njohurive, shprehive, kompetencave kyçe dhe profesionale të nxënësit/kursantit, në përmbushje të kërkesave të standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve profesionale. Fusha 4 përbëhet nga 9 nënfushat në vijim:

- 1.Plani ditor
- 2.Rezultatet mësimore
- 3.Parimet kryesore gjatë orës së mësimimit
- 4.Ana Shkencore
- 5.Baza materiale dhe didaktike
6. Mjedisi fizik
- 7.Metodologjia
- 8.Detyrat e shtëpisë
- 9.Përsëritja
- 10.Mjedis i sigurt për të nxënëit
- 11.Nxënësit dhe kursanti me nevoja të veçanta

### **1. Plani ditor**

#### *a. Rezultati*

Të gjithë mësimdhënësit hartojnë planin ditor rregullisht në përputhje me programet mësimore, si për lëndët e kulturës së përgjithshme edhe për lëndët e kulturës profesionale, përfshirë këtu edhe modulet e praktikës profesionale. Plani i zhvillimit të moduleve të praktikës hartohet për çdo 4-6 orë mësimore. Mësimdhënësit, kanë të drejtë të hartojnë planet ditore brenda lirisë profesionale të tyre duke u mbështetur edhe në elementë të tjera të rekomanduara.

#### *b. Dobësitë*

Nga analiza e të dhënave të analizuara nga vetëvlerësimi, është arritur në përfundimin se mësimdhënësit nuk mbajnë të dhëna për nxënësit me vështirësi në të nxënë. Në planet ditore përgjithësisht nuk përcaktohen kërkesa për nxënësit me vështirësi në të nxënë. Edhe në rastet kur përcaktohen, kjo ndodh rrallë ose nuk realizohet nga të gjithë mësimdhënësit. Një problematikë tjetër është se mësimdhënësit nuk vendosin në planet ditore dy lloje rezultatesh; ata vendosin vetëm rezultatet e orës mësimore dhe jo rezultate të programeve lëndore. Evidentohet gjithashtu se zakonisht, mësimdhënësit në planet ditore nuk përfshijnë në strukturë rezultatet e programit mësimor dhe refleksione. Mungesa e rezultateve që lidhen ngushtë me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet lidhur me edukimin e barazisë gjinore është një tjetër mangësi.

### **2. Rezultatet mësimore**

#### *a. Rezultati*

Nga analiza e nënfushës është konstatuar se mësimdhënësit hartojnë dhe zbatojnë planet mësimore për të gjitha lëndët, duke specifikuar objektivat në çdo orë mësimore. Mësimdhënësit planifikojnë përdorimin e metodave dhe teknikave të përshtatshme për të arritur rezultatet në lëndë. Shumica e ofruesve zhvillojnë edhe miniteste për të vlerësuar ecurinë e nxënësve.

#### *b. Dobësitë*

Nuk janë konstatuar mangësi të theksuara për këtë nënfushë për t'i përgjithësuar në nivel kombëtar. Janë rreth 5 ofrues të cilët kanë treguar se nuk zhvillojnë miniteste rregullisht ose nuk zhvillohen në të gjitha lëndët. Mësuesit nuk paraqesin se si janë arritur rezultatet në fund të orës mësimore. Jo në të gjitha shkollat mundësohet arritja e rezultateve mësimore në nivel mesatar dhe të lartë.

### **3. Parimet kryesore gjatë orës së mësimit**

#### *a. Rezultati*

Gjatë zhvillimit të orëve mësimore në lëndët e kulturës së përgjithshme dhe lëndët e kulturës profesionale, mësimdhënësit synojnë që nxënësit të përvetësojnë konceptet dhe aftësitë e lëndëve dhe zbulimin e lidhjeve midis tyre, duke përdorur metoda të ndryshme të mësimdhënies. Mësimdhënësit synojnë që nxënësit të përfitojnë sa më shumë edhe në zhvillimin e aftësive praktike. Ndarja dhe dhënia e detyrave bëhet në mënyrë të barabartë.

#### *b. Dobësitë*

Nuk janë evidentuar dobësi të theksuara për këtë nënfushë, për t'i përgjithësuar në nivel kombëtar. Një nga pikat e dobëta më të shpeshta lidhen me mos marrjen në konsideratë të aspekteve gjinore si dhe në mos konkretizimin e mësimit me ngjarje dhe situata nga jeta e përditshme.

### **4. Ana Shkencore**

#### *a. Rezultati*

Mësimdhënësit zotërojnë anën shkencore të lëndës, konceptet themelore të lëndëve që japin mësim dhe bëjnë përpjekje që nxënësit të aftësohen në zbulimin e koncepteve teorike të lëndëve si dhe lidhjen e tyre me lëndë të tjera edhe të klasave të mëparshme.

#### *b. Dobësitë*

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit si dhe të dhënat e analizuara nga *scvet.al*, nuk janë evidentuar problematika për këtë nënfushë.

### **5. Baza materiale dhe didaktike**

#### *a. Rezultati*

Mësimdhënësit përgatitin vetë materialet mësimore së bashku me nxënësit për zhvillimin e orëve mësimore. Nuk janë evidentuar problematika në pajisjen e nxënësve/kursantëve me materiale

mësimore si dhe mjetet të cilat nevojiten gjatë orëve mësimore. Baza materiale që ekziston në shkollë përdoret, pavarësisht se nuk është gjithmonë në sasinë e duhur.

*b. Dobësitë*

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit si dhe të dhënave të marra nga *scvet.al*, u arrit në konkluzionin se mësimdhënësit nuk kanë bashkëpunim me komunitetin dhe prindërit për krijimin e mjeteve mësimore. Edhe në rastet kur është kërkuar ndihmë nga prindërit, ata nuk kanë reaguar. Disa mësimdhënës përdorin TIK gjatë zhvillimit të orëve mësimore dhe kjo vjen si pasojë e mungesës së këtyre pajisjeve ose numrit të kufizuar të tyre. Në disa raste evidentohet edhe mungesa e njohurive të mësimdhënësve dhe instruktorëve për të përdorur pajisjet TIK, kur ofruesi ka të tilla. Gjithashtu bazat materiale nuk janë në sasinë e duhur të të gjithë ofruesit për të mbuluar të gjithë numrin e nxënësve.

## **6. Mjedisi fizik**

*a. Rezultati*

Mjediset fizike ku zhvillohet mësimi janë të përshtatshme për të vënë në zbatim teknikat e përzgjedhura, në përputhje me numrin e nxënësve duke mundësuar edhe zhvillimin e punës në grupe të vogla.

*b. Dobësitë*

Nuk janë evidentuar problematika të theksuara për këtë nënfushë, për t'i përgjithësuar në nivel kombëtar. Disa prej ofruesve kanë treguar se nxënësit nuk kanë mundësi të vendosin punimet individuale ose në grup në vende të dukshme. Në një ofrues ka konstatuar se kjo ka ardhur për arsye se mësimi është zhvilluar në një ambient tjetër. Një ofrues tjetër ka thënë se në disa drejtime që ofron mjedisi nuk plotëson kushtet e nevojshme të tilla si hapësira dhe lirshmëria për të lëvizur.

## **7. Metodologjia**

*a. Rezultati*

Mësimdhënësi zbaton në orët mësimore metodat dhe teknikat e planifikuara në planet ditore. Nxënësit angazhohen edhe në punë individuale edhe në punë në grup, gjatë orëve mësimore, dhe në këtë mënyrë mundësohen edhe arritja e rezultateve. Përgjithësisht detyrat që japin mësimdhënësit synojnë përfshirje të barabartë midis djemve dhe vajzave, duke respektuar barazinë gjinore.

*b. Dobësitë*

Nuk janë evidentuar dobësi të theksuara për këtë nënfushë.

## **8. Detyrat e shtëpisë**

*a. Rezultati*

Pjesa më e madhe e mësimdhënësve u japin nxënësve detyra shtëpie, kjo është më e pranishme te shkollat se sa te Qendrat e Formimit Profesional. Detyrat e shtëpisë nuk i mbingarkojnë nxënësit. Këto detyra mund të jenë individuale ose në grupe pune.

*b. Dobësitë*

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit dhe platformës *scvet.al* është arritur në përfundimin se detyrat e shtëpisë që do t'u jepen nxënësve vendosen nga mësimdhënësit; nxënësit nuk për zgjedhin vetë detyrat e shtëpisë. Edhe ofruesit të cilët kanë treguar se nxënësit i zgjedhin vetë detyrat e shtëpisë kjo ndodh ndonjëherë ose shumë rrallë. Në detyrat e shtëpisë shumë rrallë ka kërkesa për përdorimin e TIK. Në detyrat e shtëpisë nuk përfshihen situata të nxëni që lidhen me edukimin dhe barazinë gjinore. Detyrat e shtëpisë jepen vetëm me një nivel vështirësie.

## **9. Përsëritja**

*a. Rezultati*

Orët e përsëritjes së kapitujve janë të planifikuara nga mësimdhënësit në plane mësimore. Nxënësit marrin pjesë gjatë orëve të përsëritjes e cila planifikohet të realizohet në mënyrë individuale edhe në grup.

*b. Dobësitë*

Provimi vjetor me shkrim nuk realizohet në të gjithë ofruesit. Edhe në ofruesit në të cilat drejtoria ka zhvilluar një provim, ky provim është zhvilluar vetëm në disa lëndë.

## **10. Mjedis i sigurt për të nxënësit**

*a. Rezultati*

Nga analiza e të dhënave të mbledhura nga vetëvlerësimi për të gjithë ofruesit u konstatua se mjedisi i të nxënësit është pozitiv dhe nxënësit janë të lirshëm për të ndërvepruar dhe për të shprehur mendimet e qëndrimet e tyre. Mbizotëron komunikimi bashkëpunues në marrëdhënien mësues-nxënës. Nuk janë raportuar raste diskriminimi për grupe të ndryshme nxënësish në klasë ose në ambientet e zhvillimit të praktikës ose përdorim të dhunës verbale dhe fizike.

*b. Dobësitë*

Nuk janë konstatuar dobësi për këtë nënfushë.

## **11. Nxënësit dhe kursanti me nevoja të veçanta**

*a. Rezultati*

Ofruesit kanë të identifikuar nxënësit me nevoja të veçanta. Ka raste kur planet PEI janë hartuar vetëm për lëndët e kulturës së përgjithshme si gjuhë shqipe, letërsi, matematikë. Mësimdhënësit, në mungesë të mësuesit ndihmës apo planeve PEI përpiqen brenda mundësive të tyre me ndihmën e psikologut (në ofruesit që kanë) për t'u ardhur në ndihmë këtyre nxënësve duke




përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të tyre. Mësimdhënësit shfaqin vlerësim pozitiv në sjelljet dhe përpjekjet e këtyre nxënësve, për t'i motivuar ata.

#### b. Dobësitë


Nga analiza e të dhënave të raportuara në *scvet.al* dhe raportet e vetëvlerësimit u konstatua se ka edhe nxënës me nevoja të veçanta të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacionin përkatës. Nuk hartohen dhe zbatohen plane PEI për nxënësit me nevoja të veçanta. Disa ofrues nuk kanë mësues ndihmës. Nuk përdoren pajisje dhe materiale të përshtatura për llojin e paaftësisë që kanë nxënësit. Në disa ofrues nuk jepen detyra shtëpie për nxënës me nevoja të veçanta, mund të jepen shumë rrallë ose jo nga të gjithë mësimdhënësit, kjo për arsye se mësimdhënësit kanë vështirësi në gjetjen e detyrës së shtëpisë së përshtatshme për ta.

Në grafikun e mposhtëm tregohet vlerësimi për secilin prej 44 ofruesve publikë të AFP-së për fushën 4 “Mësimdhënia dhe të nxënët”.


Rezultati fushës “Mësimdhënia dhe të nxënët” sipas institucioneve



Nga analiza e të dhënave sasiore për 44 ofruesit publikë të AFP-së për fushën 4 “Mësimdhënia dhe të nxënët”, është arritur në përfundimin se 14 ofrues e kanë vlerësuar veten e tyre “Shumë mirë”, 34 prej tyre e kanë vlerësuar veten e tyre “Mirë”. Nuk ka asnjë ofrues AFP-je që ta ketë vlerësuar veten “Mjaftueshëm”, ose “Dobët”.



Grafiku i mëposhtëm tregon vlerësimin për secilën nënfushën të fushës 4 “Mësimdhënia dhe të nxënit” për të gjithë ofruesit publikë të AFP-së.



## FUSHA 5 - VLERËSIMI

Ky proces përfshin vlerësimin periodik dhe përfundimtar të njohurive të nxënësve/kursantëve. Qëllimi kryesor i vlerësimit është të vlerësojë përparimin e nxënësve/kursantëve në programet e tyre dhe të ndihmojë në përmirësimin e procesit të nxënies. Vlerësimi është një proces që ka ndikim në motivimin e nxënësve dhe në vlerësimin e sukseseve të tyre përmes informacionit të dhënë nga mësuesi/instruktori, testet dhe portofoli i nxënësit.

Kjo fushë përbëhet nga gjashtë nënfusha:

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit
2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit
3. Procesi i vlerësimit
4. Arritjet
5. Rivlerësimi
6. Ankimimet

### **1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit**

#### *a. Rezultati*

Tashmë vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit është kthyer përgjithësisht në një proces standard, në të cilin ofruesit janë përshtatur dhe nuk kanë problem për zbatimin e tij sipas udhëzimeve.

#### *b. Dobësitë*

Bazuar në raportet, disa ofrues ende nuk kanë mundur të realizojnë bashkëpunimin midis mësimdhënësve dhe nxënësve për të pasur një vendimmarrje të përbashkët për punimet që do të përfshihen në dosje/portofol dhe kjo, sipas ofruesve, vjen si rrjedhojë e nivelit të ulët të nxënësve.

### **2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit**

#### *a. Rezultati*

Ofruesit realizojnë në formë procedurale, korrekte dhe standarde vlerësimin përfundimtar të nxënësve/kursantëve dhe Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional duke respektuar udhëzimet zyrtare.

#### *b. Dobësitë*

Nuk është përmirësuar mjaftueshëm përfshirja e përfaqësuesve të biznesit në Komisionet e vlerësimit përfundimtar të praktikës profesionale. Ofruesit vazhdojnë të hasin në këtë sfidë edhe pse kanë marrë masa për përmirësimin e kësaj pike, nëpërmjet sensibilizimit, ftesave zyrtare, por ende nuk kanë marrë një rezultat pozitiv për gatishmërinë e biznesit.

### **3. Procesi i vlerësimit**

#### *a. Rezultati*

Raportet tregojnë se mësuesit/instruktorët kanë një program vlerësimi të hartuar paraprakisht, i cili është i qartë dhe njoftohen me të palët e interesuara. Ky program përfshin një gamë të gjerë mjetesh dhe teknikash vlerësimi, dhe për të arritur këtë qëllim, ata përdorin shënime dhe dëshmi të ndryshme për të vlerësuar progresin e studentëve/kursantëve.

*b. Dobësitë*

Mësuesit/instruktorët nuk përdorin mjaftueshëm apo aspak teknika që nxënësit/kursantët të vlerësojnë veten dhe njëri-tjetrin, sepse mendojnë se niveli i nxënësve nuk është i mjaftueshëm për të realizuar këtë vlerësim.

#### **4. Arritjet**

*a. Rezultati*

Ofruesit e AFP-ve zhvillojnë analizën e rezultateve të nxënësve, përfshirë analizat përkatëse të Provimit të Maturës Shtetërore Profesionale, provimeve të Teorisë Profesionale të Integruar dhe vlerësohen rezultatet e kursantëve në provimin përkatës të kurseve të unifikuara. Provimet përfundimtare realizohen korrektësisht duke ndjekur udhëzimet e përcaktuara nga institucionet përkatëse. Sakaq mësuesit raportojnë rregullisht tek prindërit për të ndarë informacionin mbi performancën e nxënësve.

*b. Dobësitë*

Vërehen situata kur ofruesit e AFP-së nuk kryejnë analizën e testimeve të Provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale në përputhje me programet e lëndëve përkatëse, sepse nuk kanë akses tek ekzemplaret e testeve. Sa i përket përputhshmërisë së rezultateve të Provimeve Përfundimtare të Teorisë dhe Praktikës Profesionale të integruar me vlerësimin e brendshëm të ofruesve të AFP-së dhe përfaqësuesve të biznesit, kjo analizë nuk realizohet tek çdo ofrues, pasi shpesh herë këta të fundit nuk janë pjesë përbërëse e Komisioneve të Vlerësimit. Shpesh herë rezultatet e arritura të nxënësve nuk janë të reflektuara me kriter ndarjen gjinore.

#### **5. Rivlerësimi**

*a. Rezultati*

Është një sistem i mbështetur në baza ligjore, që i siguron nxënësve/kursantëve mundësinë për kërkuar rivlerësimin. Nga deklaratimet e ofruesve nuk duket të përdoret shpesh ky mekanizëm, por është i aplikueshëm kur e dikton nevoja.

*b. Dobësitë*

Nuk janë paraqitur problematika në zbatim të këtij procesi.

#### **6. Ankimimet**

### a. Rezultati


Në këtë nënfushë, ofruesit e AFP-ve kanë arritur të përmbushin detyrimet ligjore duke parashikuar në rregullore procedurat e ankimimit. Procedurat e krijuara marrin në trajtim çdo ankesë që adresohet dhe përgjigjet përmbushen në afatet e caktuara.

### b. Dobësitë


Nga të dhënat e raporteve vërehet se 3 prej ofruesve të AFP-së edhe këtë vit nuk kanë një procedurë zyrtare ankimimi, apo procedura e ankimimit nuk është pjesë e rregulloreve të brendshme të tyre.

Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitet si më poshtë.


Rezultati fushës "Vlerësimi" sipas institucioneve




Në formë grafike rezultati i nënfushave të Fushës 5 "Vlerësimi" do të paraqitet si më poshtë:



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën "Vlerësimi" ka rezultuar se 29 prej tyre e shohin vetën "Shumë mirë" në këtë fushë, 15 prej tyre e shohin vetën "Mirë", ndërkohë asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar vetën "Mjaftueshëm" ose "Dobët". Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:



Në grafikun e mëposhtëm paraqitet për secilën prej fushave të vetëvlerësimit, në nivel kombëtar për të gjithë ofruesit publikë të AFP-së.



## **GJETJE TË EVIDENTURA NË RAPORTET E VETËVLERËSIMIT**

Nga shqyrtimi i 44 raporteve të vetëvlerësimit të IoAFP-ve në nivel kombëtar dalin një sërë gjetjesh që duhen marrë në konsideratë:

### **1. Subjektiviteti në procesin e vetëvlerësimit**

IoAFP-të kanë lirinë e plotë të kryejnë vetëvlerësime për vetë institucionin e tyre si dhe të aktorëve që bashkëpunojnë. Në fund të vlerësimit ofruesit hartojnë raportin ku tregohet niveli i cilësisë, arritjet, sfidat etj.

Vetëvlerësim i ndryshëm i ofruesve sjell një pabarazi dhe një perceptim shumë të ndryshëm dhe jo real. Nëse krahasojmë të njëjtën fushë nga një IoAFP në një tjetër vërehet se marzhi i vlerësimit është i ndryshëm dhe që realisht nuk përputhet me kapacitetin e vetë IoAFP-ve. Mekanizma rregullues duhet të shtohen në fund ose përgjatë procesit të vlerësimit për të evituar vlerësimet jo reale, siç mund të jenë mbivlerësimet apo nënvlerësimet.

## **2. Unifikim i raportit të vetëvlerësimit.**

Vërehet se hartimi i raporteve të vetëvlerësimit nga IoAFP-të nuk është i unifikuar megjithëse formati është i njëjtë, sërish ai nuk plotësohet siç duhet nga një pjesë e IoAFP-ve.

## **3. Cilësia e shkrimit të raportit.**

Cilësia e shkrimit të raporteve mbetet një pikë e dobët e IoAFP-ve. Drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me NJZH duhet të përzgjedhin personel dhe t'i trajnojnë për shkrimin e raportit të vetëvlerësimit. Cilësia në shkrimin e raporteve do të nxjerrë në pah më qartë gjendjen e IoAFP-së.

## **4. Përdorimi me efikasitet i instrumenteve të ndryshëm analitikë (analizën SWOT)**

Kategorizimi i gjetjeve shpesh nuk është i qartë dhe nuk ka një klasifikim të duhur në analiza SWOT. Shpesh IoAFP-të nuk klasifikojnë si duhet pikat e forta, pikat e dobëta, shanset, kërcënimet; definicionet e tyre janë jo të qarta.

## **5. Mangësi në plotësimin e platformës *scvet.al***

Sërish IoAFP-të shfaqin të meta në lidhje me plotësimin e platformës *scvet.al*. IoAFP-të nuk sinkronizojnë apo plotësojnë platformën apo në disa raste janë kontradiktore thëniet e tyre. Ka mangësi të natyrës, ku argumentet nuk përputhem me evidencat. Vihet re që nuk listohen evidencat mbështetëse.

## **6. Plani i përmirësimit**

Jo të gjithë IoAFP-të kanë përdorur instrumentin e përmirësimit si pjesë integrale e raportit të vetëvlerësimit dhe si rezultat ka munguar plani i përmirësimit të IoAFP-së në fund të raportit të vetëvlerësimit, një kërkesë e shtuar nga AKAFPK-ja në fund të muajit Dhjetor 2022.

## **7. Shkrimi zyrtar**

Përgjatë shkrimit të raportit të vetëvlerësimit apo edhe të dokumenteve të tjera që ofruesit hartojnë, konstatohet që ka mangësi edhe në nivel përdorimi i shkrimit zyrtar, aq më shumë kur ofruesit janë institucione të arsimit. Nuk përdoret gërmat “ë”, “Ë”, “ç”, “Ç”.

## **REKOMANDIME**

### **FUSHA 1**

#### **Nënfusha 1**

1. Rekomandohet të bëhen përpjekje për të nxitur më shumë përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e organizmave të ofruesve të AFP-së.

#### **Nënfusha 3**

2. Rekomandohet të bëhen më shumë përpjekje për të siguruar një përfshirje më të madhe dhe një bashkëpunim më të ngushtë me aktorët e jashtëm në hartimin e planit vjetor të ofruesve.

#### **Nënfusha 7**

3. Rekomandohet që ofruesit e AFP-së të bëjnë më shumë përpjekje për një cilësi më të mirë në shkrimin e raporteve të vetëvlerësimit duke shmangur përsëritjet nga raportet e viteve të kaluara.

### **FUSHA 2**

#### **Nënfusha 1**

4. Të intensifikohen marrëdhëniet me qeverinë vendore.
5. Të krijohen marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes vendore për realizimin e praktikave profesionale pranë tyre.
6. Të planifikohen dhe zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me institucionet vendore.

#### **Nënfusha 2**

7. Të zhvillohet analiza periodike e tregut për zonën ku IoAFP-të zhvillojnë veprimtarinë.
8. Të planifikohen dhe zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me biznesin.

#### **Nënfusha 3**

9. Të realizohet identifikimi, studimi dhe menaxhimi i të dhënave të OJF-ve.
10. Të hartohen projekte zhvillimore për të siguruar mbështetje nga OJF-të.
11. Të planifikohen dhe zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe OJF-të.

#### **Nënfusha 4**

12. Të zhvillohen binjakëzime me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit.
13. Të zyrtarizohen marrëdhëniet me institucionet e Arsimit të Lartë dhe arsimit pas të mesëm.



### **FUSHA 3**

#### **Nënfusha 3**

14. Rekomandohet që mësimdhënësit të dokumentojnë çdo përpjekje që bëjnë me nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe të drejtojnë kërkesë në institucionet përgjegjëse në zbatim të udhëzimit nr. 13, datë 13.4.2022 “Për mësuesin ndihmës dhe ngritjen e funksionimit të komisionit për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit profesional”.

#### **Nënfusha 4**

15. Të nxitet bashkëpunimi i prindërve në krijimin e mjeteve mësimore.

16. Ofruesit që kanë probleme me ndërtesën e shkollës, duhet të bëjnë përpjekjet duke kërkuar mbështetjen e institucioneve përgjegjëse, ose të projekteve nëse janë pjesëmarrës.

#### **Nënfusha 5**

17. Në ekipet kurrikulare rekomandohet të ftohen në mbledhje përfaqësues të Bordit, të Qeverisë së Nxënësve dhe Këshillit të Prindërve të shkollës.

### **FUSHA 4**

#### **Nënfusha 1**

18. Rekomandohet që mësimdhënësit të përcaktojnë në planet ditore:

- Mangësitë e nxënësve me vështirësi në të nxënë.
- Kërkesa për nxënësit me nevoja të veçanta
- Aspektet gjinore si p.sh rezultate mësimore, situatë mësimore, terminologji etj.
- Rezultatet sipas programit mësimor
- Koha për refleksion

#### **Nënfusha 3**

19. Rekomandohet që mësimdhënësit të marrin në konsideratë gjatë shtjellimit të lëndës konkretizimin me ngjarje nga jeta e përditshme, duke përfshirë edhe aspektet gjinore.

#### **Nënfusha 5**

20. Të nxitet bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin në krijimin e mjeteve mësimore.

21. Të bëhen përpjekje për shtimin e bazës materiale për kualifikimet profesionale që ofrohen.

#### **Nënfusha 6**

22. Të krijohen hapësira për ekspozimin e punimeve individuale dhe në grup të nxënësve.

#### **Nënfusha 8**

23. T’u jepen mundësia nxënësve të përzgjedhin vetë për detyrat e shtëpisë.

24. Të bëhen përpjekje nga mësimdhënësit për rritjen e nivelit të nxënësve nga i ulët në nivel mesatar dhe të lartë.
25. Në detyrat e shtëpisë rekomandohet të ketë kërkesa për përdorimin e TIK dhe edukimit dhe barazisë gjinore.
26. Të realizohet provimi vjetor në të gjitha lëndët.

#### **Nënfusha 11**

27. Të hartohen planet PEI për nxënësit me nevoja të veçanta në bashkëpunim me mësuesit ndihmës dhe psikologun e shkollës.

#### **FUSHA 5**

##### **Nënfusha 1**

28. Të përforcohet bashkëpunimi midis mësimdhënësve dhe nxënësve/kursantëve për një vendimmarrje të përbashkët për punimet që do të përfshihen në dosje/portofol.

##### **Nënfusha 2**

29. Të planifikohen aktivitete sensibilizimi me përfaqësuesit e biznesit për të kuptuar rëndësinë e pjesëmarrjes në Komisionet e Provimeve përfundimtare të praktikës profesionale.

##### **Nënfusha 3**

30. Të përdoren më aktivisht teknika e “vetëvlerësimit të nxënësit/kursantit” si dhe “vlerësimi për njëri-tjetrin”.

##### **Nënfusha 4**

31. Të kryhet analiza e testimeve të Provimeve të Maturës Shtetërore profesionale në përputhje me programet e lëndëve përkatëse.
32. Të reflektohen rezultatet e arritura të nxënësve sipas ndarjes gjinore.